

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-055/13

**Prishtinë,
3 Prill 2014**

Në çështjen juridike të:

B B

S

P

Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë

kundër.

S (S) J

V V 35 27

11090 B – R BG

S

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi e kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini , Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/163/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA56727), të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 3 Prill 2015, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B B kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/163/201 të datës 5 shtator 2012, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA56727.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/163/2012 të datës 5 shtator 2012, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA56727.

Përmbledhja faktike dhe procedurale:

1. Më 3 dhjetor 2007 S (S) J (*në tekstin e mëtejme*: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (*në tekstin e mëtejme*: AKP) ku ka kërkuar të drejtën pronësore dhe riposedimin ndaj një ngastre nr. 746, në sipërfaqe prej 19 ar 86 m², e evidentuar në Fletën Poseduese nr. 378, Zona Kadastrale Sofali/Sofalija, Komuna e Prishtinës (*në tekstin e mëtejme*: prona e kërkuar). Ai ka deklaruar se pronën e kërkuar së bashku me nënën e tij e kanë trashëguar nga babai rrespektivisht burri - Sretko Jovanovič, në vitin 1969, atëherë kur e kishte transferuar pronën e kërkuar në emër të tyre (për secilin ½ e pjesës ideale të saj). Paraqitësi i kërkesës më tutje deklaroi se pas vdekjes së nënës së tij - Z J, pjesën e saj dmth ½ e pjesës ideale të pronës së kërkuar e kishte trashëguar vëllau i tij bashkëpronar T (S) J në bazë të vendimit mbi trashëgiminë.

Paraqitësi i kërkesës pretendon se e ka humbur posedimin e pronës me 12 qershor 1999, si rezultat i rrethanave të vitit 1998/1999.

2. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës në mes tjerash ka paraqitur edhe këto dokumente:
 - Vendimi i trashëgimisë VT.Nr.184/78, i nxjerrë nga Gjykata Komunale e Prishtinës me datë 14 shtator 1978. Sipas këtij aktvendimi T (S) J - vëllau bashkëpronar në pronën e kërkuar i paraqitësit të kërkesës është shpallur trashëgimtar i Z J-it në disa ngastra-prona të listuara. Ky aktvendim mbi trashëgiminë nuk përfshin ngastrën-pronën e kërkuar, e cila është objekt kontesti i kërkesës së paraqitur (dmth aktvendimi i sipërcituar nuk i referohet pronës së kërkuar);
 - Fletën Poseduese nr. 378, e nxjerrë nga Qendra për Kadastër dhe Paluajtshmëri, Zyra Republikane e Gjeodezisë, Komuna Kadastrale e Sofalisë, Komuna Qyteti-i Prishtinës, Republika e Serbisë me datë 22 nëntor 2001. Sipas këtij dokumenti prona e kërkuar është e regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës dhe vëllaut të tij bashkëpronar (secili në ½ e pjesës ideale të saj);

- Çertifikata e vdekjes së S J (babait të paraqitësit të kërkesës nr. 203-9073/03-IV, e nxjerrë nga Komuna e Prishtinës në Nish, Republika e Serbisë me datë 16 prill 2003. Kjo çertifikatë konstaton faktin se babai i paraqitësit të kërkesës kishte vdekur me 8 janar 1996;
 - Çertifikata e vdekjes së babait të paraqitësit të kërkesës nr. 203-124-06-08/16307, e nxjerrë nga Komuna e Prishtinës në Nish, Republika e Serbisë me datë 18 korrik 2006;
 - Çertifikata e lindjes së babait të paraqitësit të kërkesës nr. 200-12964/09-08-34529, e nxjerrë nga Komuna e Prishtinës në Nish, Republika e Serbisë me datë 27 gusht 2009;
 - Çertifikata e martesës midis babait (S J) dhë nënës (Z Đ – J) së paraqitësit të kërkesës nr. 202-1604/09-08-34527, e nxjerrë nga Komuna e Prishtinës në Nish, Republika e Serbisë me datë 27 gusht 2009;
 - Leternjoftimi i paraqitësit të kërkesës nr. 1012944910028, i nxjerrë me datë 2 nëntor 1999 nga Republika e Serbisë.
3. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 13 korrik 2012, shihet se AKP-ja ka verifikuar pozitivisht (përveq çertifikatës së martesës nr. 202-1604/09-08-34527 e datës 27 gusht 2009 dhe vendimit të trashëgimisë VT.Nr.184/78 datë 14 shtator 1978) dokumentet e sipërluara dhe të paraqitura nga ana e paraqitësit të kërkesës. Ndërsa, sipas raportit tjetër paraprak dmth atij të datës 15 maj 2008, shihet se Njësia e Verifikimit të AKP-ës *ex officio* ka siguruar fletën poseduese nr. 378, e nxjerrë nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovës (UNMIK) me datë 14 maj 2008, sipas së cilës në mes të tjerash edhe prona e kërkuar është regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës dhe vëllaut të tij Trajko (Sretko) Jovanović si bashkëpronar – secili në ½ e pjesës ideale të saj.
4. Me datën 5 gusht 2008, B B (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë) i është ofruar AKP-ës dhe ka kërkuar të drejtë ligjore në pronën e kërkuar duke nënshkruar lajmërimin për pjesëmarrjen në procedurë. Në deklaratën e dhënë në formularin e kërkesës pala përgjegjëse deklaroi se “ka bërë pazar” (ka blerë) pronën e kërkuar nga personi R (S) J (me vonë pala përgjegjëse në kërkesë këtij personi i referohet si S J) dhe se i ka dorëzuar atij shumën prej 2000DM. Ai me tutje ka shtuar se është i gatshëm që të paguaj shumën tjetër të parave si borxh këtij pronari të pronës së kërkuar, por çmimin shitëblerës të përcaktuar nga eksperti gjyqësor si çmim real i tregut. Me qëllim që të mbështetjes së pretendimeve të tija, pala përgjegjëse në kërkesë ka paraqitur këtë dokumentacion:
- Deklaratën e tij të datës 5 shtator 2008. Sipas kësaj deklaratë, pala përgjegjëse thekson se ai e kishte blerë pronën e kërkuar dhe se personi me emrin R (S) J (me vonë pala përgjegjëse në kërkesë këtij personi i referohet si S J) i kishte lejuar atij që në pronën e kërkuar të ndërtonte shtëpitë;

- Vërtetimin e nxjerrë nga ana e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), Stacioni Policor i Veriut, Sektori i Hetuesisë në Prishtinë me datë 17 gusht 2007. Ky vërtetim i lëshuar konstaton faktin se pala përgjegjëse ka paraqitur rastin nr. 00/15445 në polici së i është djegur shtëpia e banimit dhe se i janë shkaktuar dëme materiale;
 - Letra e datës 25 korrik 2011 e pala përgjegjëse – përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, Avokatit H L, adresuar Drejtorit Ekzekutiv të AKP-ës. Në këtë letër pala përgjegjëse në kërkesë njofton AKP-ën, se në lidhje me të njëjtën çështje ishte inicuar procedurë gjyqësore edhe para Gjykatës Komunale në Prishtinë. Më tutje ai ka shpjeguar edhe historinë e blerjes së pretenduar të pronës së kërkuar nga S J [për ndryshim nga ajo që më përpara pala përgjegjëse në kërkesë i referohej si R (S) J];
 - Një fotografi (me gjasë të pronës së kërkuar) dhe hartë të pa datë dhe numër; dhe
 - Leternoftimi i palës përgjegjëse në kërkesë nr. ID03187821 të lëshuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Mbrendshme (MPB) të Republikës së Kosovës me datë 21 maj 2010.
5. Me datën 7 mars 2012, pala përgjegjëse në kërkesë përmes përfaqësuesit të tij – Avokatit H L, përsëri i drejtohet Drejtorit Ekzekutiv të AKP, duke e shpjeguar të njëjtat fakte, situata dhe pretendime sikur edhe në letrën e tij paraprake atë të datës 25 korrik 2011.

Si përgjigje në këto dy shkresa të sipërcituara dhe të paraqitura nga ana e palës përgjegjëse në kërkesë, paraqitësi i kërkesës [shkresat ishin nënshkruar edhe nga vëllau i tij bashkëpronar në pronën e kërkuar T (S) J] fillimisht me datën 26 nëntor 2011, e pastaj edhe me datën 26 dhjetor 2012, ka paraqitur deklaratë me shkrim dhe më përmbajtje pothuajse të njëjtë, duke theksuar se ai dhe vëllau i tij janë pronar të pronës së kërkuar dhe se ata nuk e kishin shitur asnjëherë atë. Më tutje ai ka kërkuar edhe kthimin e posedimit të pronës së kërkuar.

6. Më 5 shtator 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/163/2012, e pranoi kërkesën. Në paragrafin 50 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit individual të vërtetuar të datës 27 dhjetor 2012, vlen posaçërisht për këtë kërkesë, theksohet se në mesin e dokumenteve që paraqitësi i kërkesës i kishte paraqitur në mbështetje të kërkesës së tij, ishte edhe Fletë Poseduese nr. 378 e datës 14 maj 2005, e cila ishte verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-ës. Kjo Fletë poseduese si e tillë konstatonte se prona e kërkuar ishte regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës dhe vëllaut të tij si bashkëpronar (secili në ½ e pjesës ideale). Në paragrafin 51 të të njëjtit vendim theksohet që pala përgjegjëse pretendon se e kishte blerë pronën e kërkuar në vitin 2000 në bazë të kontratës së shitëblerjes me babain e paraqitësit të kërkesës. Ky paragraf më tutje thekson se “[...Megjithatë, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një certifikatë vdekjeje të

verifikuar pozitivisht, e cila dëshmon se babai i paraqitësit të kërkesës kishte vdekur më 1996]”. Ndërkaq, paragrafi 52 përfundimisht konstaton se “[Bazuar në dëshmitë para tij, komisioni konsideron se ai nuk mund të mbështetet në kontratën e blerjes së paraqitur nga pala përgjegjëse. Rrjedhimisht kërkesa dubet të miratohet]”.

7. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë) më 25 shkurt 2013, ndërsa palës përgjegjëse në kërkesë i është dorëzuar me datë 31 janar 2013. Më 19 shkurt 2013, pala përgjegjëse në kërkesë (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) e ka kundërshtuar vendimin në Kolegjin e Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Ankesa e ushtruar nga pala ankuese i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më datë 5 prill 2013, ndërkaq që me datën 29 prill 2013 ajo ka paraqitur edhe përgjigje në ankesë. Gjykata Supreme e ka pranuar dosjen e lëndës më 12 prill 2013.

Pretendimet e palëve:

Pala ankuese/Pala përgjegjëse në ankesë:

8. Pala ankuese në ankesën e tij të ushtruar pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor, rrespektivisht moszbatim të ligjit procedural dhe se mbështetet në vlerësimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
9. Në procedurën para AKP/KKPK-ës pala ankuese pretendon se ai dhe fqinji i tij L F, në vitin 2000 në emër të shitëblerjes si kapar-avanc ia kishin paguar S J-it (babait të paraqitësit të kërkesës) shumën e parave në vlerë prej 20.000DM. Sipas palës ankuese, S J-i iu kishte dhënë atyre - atij dhe fqinjit të tij L F) një deklaratë sipas së cilës dëshmonte se kishte pranuar këtë shumë parash. Pala ankuese, gjithashtu pretendon se ai dhe fqinji i tij ishin marrë vesh me S J-in, që pas një muaji ai (Sreteni) do t'ua dorëzonte atyre dokumentacionin e kompletuar në vendkalimin kufitar në Merdare në mënyrë që të realizohej shitëblerja e pronës së kërkuar. Megjithatë, ai nuk kishte ardhur dhe nuk kishte sjellur dokumentet origjinale të premtuara, prandaj ata (pala ankuese dhe fqinji) i tij kishin humbur lidhjet me të, meqë S J nuk përgjigjej më në thirrjet telefonike të tyre. Më tutje, pala ankuese deklaron se dokumentacioni i dorëzuar atij nga S J (me gjasë ai mendon në deklaratën mbi pranimin e kaparit-avancit) i ishte djegur në vitin 2000, atëhere kur shtëpia e tij ishte djegur gjithashtu. Për të dëshmuar këtë, pala ankuese ka ofruar një vërtetim të lëshuar nga Shërbimi Policor i Kosovës, Stacioni i Hetuesisë i datës 17 gusht 2007, i cili konstaton se B B – pala ankuese kishte raportuar rastin e djegjes së shtëpisë së tij. Pala ankuese përfundimisht duke deklaruar se ishte mashtruar nga S J (megjithatë pala ankuese nuk thekson nëse S J ishte personi i gabuar të cilit ai ia kishte paguar shumë e parave të sipërcekur) ka treguar gatishmërinë e tij që palës përgjegjëse në ankesë (S J-it) dhe vëllaut të tij T J

(bashkëpronar i pronës së kërkuar) në emër të shitëblerjes së pronës së kërkuar të ua paguaj çmimin real të tregut i cili do të përcaktohej nga eksperti, ose që do të kompensoj pronën e kërkuar me pronë tjetër në Sofali ose në ndonjë fshat tjetër të banuar me komunitet serb.

10. Në ankesën e tij të ushtruar pranë Gjykatës Supreme, pala ankuese ka përsëritur pothuajse të njejtat pretendime si edhe ato të shfaqura para AKP/KKPK-ës, por me dallimin se pronën e kërkuar në vitin 2000 ai dhe fqinji i tij e kishin blerë nga pala përgjegjëse në ankesë (dhe jo nga S J). Më tutje, pala ankuese thekson se ata (ai dhe fqinji i tij) kishin marrë pëlqimin e palës përgjegjëse në ankesë për ndërtimin e shtëpive të tyre në pronën e kërkuar. Pala ankuese përfundimisht thekson se asnjëherë nuk kishin arritur marrëveshje me pronarët e pronës së kërkuar, për shkak se ata po kërkonin një çmim shumë të lartë sesa çmimi real i tregut.

Prandaj, pala ankuese i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës, që ankesa e tij të shqyrtohet dhe vendimi i ankimuar të ndryshohet, ndërsa lënda t'i kthehet AKP/KKPK-ës për rivendosje.

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i ankesës:

11. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se ai dhe vëllau i tij T J janë bashkëpronar secili në ½ e pronës së kërkuar mbi bazën e procedurës trashëgimore dhe pas vdekjes së nënës së tyre Z J. Më tutje pala përgjegjëse në ankesë (ankesën e ka nënshkruar edhe vëllau i tij) deklaroi se ai dhe vëllau i tij si bashkëpronar pas vdekjes së nënës së tyre nuk e kanë shitur pronën e kërkuar dhe se ata janë pronarët ekskluziv të saj. Sipas tyre ata nuk i kanë dhënë askujt në shfrytëzim pronën e kërkuar, sikur që nuk kanë dhënë as leje ose pajtim për të ndërtuar objekt ndërtimor në të. Ata deklarojnë gjithashtu se pronën e kërkuar nuk e kanë shitur, ndërkaq që marrja në posedim nga pala ankuese e pronës së kërkuar është bërë pa kurrfarë baze ligjore, pa leje dhe pa pajtimin e tyre. Sipas palës ankuese pretendimi i palës ankuese se ai kishte lidhur kontratë me Sretenin (sipas korrespondencës së datës 30 dhjetor 2009 midis AKP-ës dhe palës përgjegjëse në ankesë emri “S” ishte pseudonimi i emrit “S”) janë të pavërteta, meqë personi me këtë emër dhe mbiemër (babai i tyre) kishte vdekur me 8 janar 1996, që dmth para ngjarjeve të luftës në Kosovë. Këtë e dëshmojnë me paraqitjen e çertifikatës së vdekjes e cila konstaton të njejtën datë vdekjeje të pretenduar për S J-in. Ata pretendojnë se nuk ishin vënë asnjëherë në kontakt me palën ankuese dhe se përveq leternjoftimit ai si i tillë nuk posedon kurrfarë dokumentacioni pronësor, material ose dëshmi valide, prandaj edhe nuk ka kurrfarë të drejtë njerëzore e morale që të kundërshtojë të drejtën pronësore të tyre në pronën e kërkuar.
12. Edhe në përgjigjen në ankesë të dorëzuar me datë 12 prill 2013, pala përgjegjëse në ankesë përsërisit të njejtat pretendime si ato para AKP/KKPK-ës, por duke theksuar se i pavërtetë është edhe

deklarimi shtesë në ankesën e palës ankuese se në vitin 2000 ai kishte arritur një marrëveshje me Stanimir Jovanović-in (dhe jo me S J-in). Për më tepër sipas tyre, pala ankuese ndryshimin e emrave të personave më të cilët ai pretendon se ka arritur shitëblerjen e pronës së kërkuar e bënë qëllimisht në mënyrë që të sjell në huti gjykatën. Përfundimisht, pala përgjegjëse në ankesë në përgjigjen e tij në ankesë (përgjigjen në ankesë e ka nënshkruar edhe vëllau i tij bashkëpronar) deklaroi se ishte munduar të gjente një rrugë miqësore dhe të rregullonte çështjen kontestuese në fjalë, por pala ankuese i kishte i kërcenuar njëzë e tjerë të cilët ishin munduar të vëheshin në kontakt me të si pronar i pronës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor

13. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (*këtej e tutje Ligji nr. 03/L-079*) dhe është e pranueshme.
14. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e vet në faktin se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së në mesin e dokumenteve të paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë, ka verifikuar pozitivisht Fletën Poseduese nr. 378, e datës 14 maj 2005. Kjo Fletë Poseduese konstaton se prona e kërkuar është regjistruar në emër të palës përgjegjëse në ankesë dhe vëllaut të tij T J, secili në ½ e pronës së kërkuar.
15. Gjykata Supreme konstaton se vendimi i ankimuar gjithashtu bazohet edhe në faktin se pala ankuese nuk kishte paraqitur ndonjë kontratë shitëblerjeje e cila do të shërbente si bazë mbështetëse e pretendimit e tij - se pala ankuese kishte blerë pronën e kërkuar. Në të vërtetë Gjykata konstaton gjithashtu se pala ankuese në shitëblerjen eventuale të pronës së kërkuar nuk ka vepruar në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Mbi Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme (GZ e RS-ës nr. 42 datë 18 nëntor 1998) i cili si i aplikuar në kohën e arritjes së shitëblerjes së pretenduar, kërkonte si kusht ekzistimin e kontratës së shitëblerjes së paluajtshmerisë në formën e shkruar dhe me nënshkrimet e palëve të vërtetuara nga ana e gjykatës.
16. Për Gjykatën është i drejtë dhe ligjshëm konstatimi në vendimin e KKPK-ës, se personi S J (babai i palës përgjegjëse në ankesë) me të cilin pala ankuese pretendon se kishte arritur blerjen e pronës së kërkuar në vitin 2000, nuk ka mundur të ishte palë në blerjen e pretenduar. Kjo, sepse sipas çertifikatës së vdekjes së vërtetuar nga AKP-ja konstatohet se ai (S J) kishte vdekur në vitin 1996. Prandaj, nga kjo Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet ankimore të palës ankuese janë pabaza dhe të papranueshme për sa i takon të drejtës pronësore në pronën e kërkuar.

17. Nga vlerësimi i shkresave të lëndës të paraqitura para AKP/KKPK-ës si dhe ankesa e ushtruar, Gjykata vëren se pala ankuese nuk është konsistent në përmendjen e emrit të personit me të cilën ai pretendon se kishte arritur blerjen e pronës së kërkuar. Ai njëherë i referohet këtij personi herë si R (S) J e herë si S J. Në fund pala ankuese deklaroi se personi me të cilin kishte arritur shitëblerjen në vitin 2000 ishte vetë pala përgjegjëse në ankesë (S J).
18. Gjykata konstaton se pala ankuese me dokumentet e paraqitura si para AKP/KKPK-ës, po ashtu edhe para Gjykatës me rastin e ushtrimit të ankesës, nuk ka dëshmuar arritjen e marrëveshjes së shitëblerjes që ai pretendon, prandaj tentimi për të paraqitur si të vërtetë faktin se ai kishte blerë pronën e kërkuar mbetet vetëm në nivelin e deklarimeve të paargumentuara. Me këtë rrjedhimisht pala ankuese nuk ka arritur të dëshmojë në asnjë mënyrë ndonjë të drejtë pronësore të tij në pronën e kërkuar, siç edhe nuk ka arritur edhe të atakoj sukseshëm konstatimin e KKPK-ës të dhënë në vendimin e saj KPCC/D/A/163/2012, të datës 05 shtator 2012, se pala përgjegjëse është pronare në ½ e pronës së kërkuar.
19. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja vendimin e saj të drejtë dhe valid e ka mbështetur në vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe në zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Prandaj, Gjykata Supreme përfundon se ankesa është e pabazuar.
20. Duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, në pajtim me nenin 13.3 nën pikën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

XXXX XXXX, Gjyqtar/e i/e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

XXXX XXXX, Gjyqtar e/i i/e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it